Njoftimi i Praktikave të Konfidencialitetit të DSHS për Informacionin Mjekësor të Klientit

DSHS Notice of Privacy Practices for Client Medical Information

Në fuqi nga 23 shtatori 2013

DSHS duhet t'ju njoftojë për të drejtat tuaja të konfidencialitetit të Ligjit mbi Lëvizshmërinë dhe Përgjegjësinë e Informacionit të Shëndetit (HIPAA). (45 CFR 164.520). DSHS është një "njësi hibrid." Jo e gjithë DSHS mbulohet nga HIPAA, vetëm programet e renditura si Elementë të Kujdesit Shëndetësor në faqen në Internet të DSHS mbulohen nga HIPAA. Ky njoftim zbatohet vetëm për klientë që nuk mbulohen nga ato programe. Ky njoftim nuk ndikon mbi kualifikimin tuaj për shërbime të DSHS.

Ky njoftim përshkruan sesi informacioni mjekësor për ju mund të përdoret dhe jepet dhe sesi mund t'a merrni këtë informacion. Ju lutemi shqyrtojeni atë me kujdes.

Ç'farë është ISHM?

Informacioni Shëndetësor i Mbrojtur (ISHM) është informacion mjekësor i klientit i mbajtur nga pjesë të DSHS të mbuluara nga HIPAA. ISHM është informacioni mjekësor që ka lidhje me ju për statusin ose gjendjen tuaj shëndetësore, kujdesin shëndetësor që merrni ose pagesën për kujdesin tuaj shëndetësor. DSHS duhet të mbrojë ISHM tuaj sipas ligjit.

Ç'farë ISHM ka DSHS për mua?

Për të na ndihmuar që t'ju shërbejmë, mund të duhet të na jepni informacion mjekësor ose shëndetësor, përfshirë vendndodhjen, informacionin shëndetësor ose të dhënat mjekësore tuaja. Gjithashtu mund të marrim ISHM për ju nga burime të tjera që nevojitet t'u shërbejnë juve ose paguajnë për kujdesin tuaj.

Kush e shikon ISHM tim?

Shohim vetëm sasinë më të vogël të ISHM që na nevojitet të bëjmë punën tonë. Mund t'a shkëmbejmë ISHM me programe ose persona të tjerë nëse lejohet sipas ligjit ose lejohet nga ju. Për shembull, ISHM mund t'u jepet dhe të përdoret nga Autoriteti i Kujdesit Shëndetësor dhe sigurues të tjerë të kujdesit shëndetësor për të bashkërenditur dhe paguar për kujdesin tuaj shëndetësor. Mund të japim ISHM të kaluar, të tanishëm ose të ardhshëm.

Ç'farë ISHM jep DSHS?

Japim ISHM tuaj vetëm që të tjerët kanë nevojë për të bërë punën e tyre dhe siç lejohet nga ligji. Mund të kërkoni një listë të atyre që kanë parë ISHM tuaj për ndonjë qëllim.

Kur e jep DSHS ISHM?

Japim ISHM sipas "nevojës për të ditur" për të bashkërenditur shërbime dhe për trajtim, pagesë dhe operacione të kujdesit shëndetësor. Për shembull, mund të japim informacion për të vendosur nëse:

- Duhet të jepet trajtim mjekësor.
- Mund të paguajmë për shërbime të siguruesve të kujdesit shëndetësor.
- Kualifikoheni për programe të DSHS.
- Kujdesi që merrni nga siguruesit përmbush standartet ligjore.

A mund të shoh ISHM tim?

Mund të shihni ISHM tuaj. Nëse e kërkoni, do të merrni një kopje të ISHM tuaj. DSHS mund t'ju kërkojë të paguani për kopjet.

A mund të ndryshoj ISHM tim?

Nëse mendoni se ISHM është i gabuar, mund të na kërkoni të ndryshoni ose të shtoni ISHM tuaj. Gjithashtu mund të kërkoni që t'u dërgojmë ndonjë ndryshim të tjerëve që kanë kopje të ISHM tuaj.

Po nëse dikush tjetër ka nevojë për ISHM tim?

Mund t'ju kërkohet të nënshkruani një formular për të na lejuar që të japim ISHM tuaj nëse:

- Kemi nevojë për lejen tuaj për të siguruar shërbime ose kujdes;
- Dëshironi që t'ia dërgojmë ISHM tuaj një agjencie ose siguruesi tjetër për arsye që nuk lejohen nga ligji pa lejen tuaj;
- Dëshironi që ISHM juaj t'i dërgohet dikujt tjetër, si avokatit tuaj, një të afërmi ose përfaqësuesi tjetër.

Leja juaj për të dhënë ISHM tuaj është e vlefshme deri në datën e skadimit që vendosni në formular. Mund të japim vetëm ISHM që rendisni. Mund të anulloni ose ndryshoni këtë leje duke i shkruar DSHS

DSHS Njoftimi i Praktikave të Konfidencialitetit për Informacionin Mjekësor të Klientit
Në fuqi më 23 shtator 2013

A mund të japë DSHS ISHM tim pa lejen time?

DSHS mund të japë ISHM pa lejen tuaj në disa raste. Sipas ligjit, mund të na kërkohet ose të lejohemi të japim ISHM tuaj. Disa shembuj përfshijnë nevojën për të:

- Njoftuar raste të abuzimit ose neglizhimit të fëmijëve ose të rriturve tek Shërbimet e Mbrojtjes së Fëmijëve, policia ose agjenci të tjera.
- Dhënë të dhëna sipas një urdhëri të gjykatës.
- Dhënë ISHM tek agjenci të tjera që shqyrtojnë operacionet e DSHS.
- Dhënë ISHM tek agjenci që liçensojnë dhe inspektojnë mjedise mjekësore, si azile dhe spitale.
- Dhënë ISHM tek siguruesit e shërbimit ose agjenci të tjera për t'u kujdesur për ju sipas nevojës për të përcaktuar nëse kualifikoheni për shërbime ose përfitime.
- Dhënë ISHM tek kujdestarët ose prindërit e të miturve.
- Përdorur ISHM për kërkim.
- Përdorur ose dhënë ISHM në rast urgjent ose për qëlime të ndihmës në rast katastrofe.

A mund të kufizoj dhënien e ISHM tim dhe sesi e marr atë?

Mund të na kërkoni të kufizojmë përdorimin dhe dhënien e ISHM tuaj, por nuk jemi të detyruar t'a pranojmë atë. Gjithashtu mund të na kërkoni t'a dërgojmë ISHM tuaj në një format të ndryshëm ose në një vendndodhje të ndryshme.

Ç'farë është një shkelje?

Një shkelje është përdorimi ose dhënia e ISHM tuaj që nuk lejohet sipas HIPAA, përfshirë humbje përmes vjedhjes, gabimit ose përdorimit të paligjshëm. Do t'ju njoftojmë përmes postës nëse ka një shkelje të ISHM sipas HIPAA.

A mund të marr një kopje të këtij njoftimi?

Po. Ky njoftim është juaji për t'a marë. Nëse e morët këtë njoftim në mënyrë elektronike, mund të kërkoni një kopje letre dhe do t'ju japim një.

Po nëse ndryshojnë praktikat e konfidencialitetit të ISHM?

Na kërkohet të veprojmë në përputhje me këtë njoftim. Kemi të drejtë të ndryshojmë këtë njoftim. Nëse ligjet ose praktikat tona të konfidencialitetit ndryshojnë, do t'ju dërgojmë informacion në lidhje me njoftimin e ri dhe ku t'a gjeni atë ose do t'ju dërgojmë atë.

Kë të kontaktoj nëse kam pyetje në lidhje me këtë njoftim ose të drejtat e ISHM tim?

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me ketë njoftim, mund të kontaktoni Punonjësin e Konfidencialiteti të DSHS në DSHSPrivacyOfficer@dshs.wa.gov ose (360) 902-8278.

Si të njoftoj një shkelje të të drejtave të konfidencialitetit të ISHM tim?

Nëse besoni se të drejtat e konfidencialitetit të ISHM tuaj janë shkelur, mund të paraqisni një ankesë tek:

The DSHS Privacy Officer, Department of Social and Health Services, PO Box 45115, Olympia WA 98504-5115 ose nëpërmjet emailit tek DSHSPrivacyOfficer@dshs.wa.gov. Nëse paraqisni një ankesë, DSHS nuk do të ndryshojë ose ndalojë shërbimet tuaja dhe nuk duhet të hakmerret ndaj jush.

OSE

Paraqisni ankesën tuaj në Internet në: https://ocrportal.hhs.gov/ocr/cp/complaint_frontpage.jsf ose duke shkruar tek: Office for Civil Rights, US Department of Health and Human Services, 200 Independence Avenue, S.W., Room 509F HHH Bldg., Washington, D.C. 20201, telefoni (800) 368-1019. Të gjitha ankesat pranë DHHS duhet të bëhen brenda 180 ditëve nga shkelja e pretenduar e konfidencialitetit.

NJOFTIMI I PRAKTIKAVE TË KONFIDENCIALITETIT PËR INFORMACIONIN KONFIDENCIAL TË DSHS
Në fuqi nga 23 shtatori 2013

Pranim

Acknowledgement

(Nevojitet kur DSHS siguron trajtim të kujdesit shëndetësor të drejtpërdrejtë)

EMRI I KLIENTIT	DATËLINDJA E KLIENTIT
Kam marë një kopje të Njoftimit të Konfidencialitetit të DSHS dhe kam patur një rast për të bërë pyetje në lidhje me atë sesi DSHS do të përdorë dhe japë Informacionin tim të Kujdesit Personal.	
NENSHKRIMI I KLIENTIT OSE PERFAQESUESIT PERSONAL	DATA

FOR DSHS USE ONLY (VETËM PËR PËRDORIMIN NGA DSHS)

To be completed if unable to obtain signature of client or personal representative.

Describe efforts made to have the client acknowledge receipt of the Notice of Privacy Practices (NPP):

Describe reason why acknowledgement was not obtained:

STAFF MEMBER'S NAME AND TITLE (PLEASE PRINT)	ADMINISTRATION/DIVISION
STAFF'S SIGNATURE	DATE